



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 24, datë 23.12.2021

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Dhjetor, që zhvillohet tek salla e Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu”

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:10

Data e mbajtjes së mbledhjes : 23.12.2021

Mbajtja e mbledhjes : salla e Qendrës Kulturore “ Aleksandër Moisiu”

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Rradhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës : Znj.Emiriana Sako, që kryen funksionet e Kryetarit Bashkisë dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi : Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare ! Të nderuar pjesmarrës !

Kjo është mbledhja e fundit për këtë vit kalendarik . Në këtë mbledhje do të shqyrtohen vendime shumë të rëndësishme, sidomos miratimi i buxhetit Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxheti afatmesëm për vitet 2022-2024.

E deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës të muajit Dhjetor.

Ftoj Sekretaren të bëj prezencën fizike.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë. Jolanda Mustafaraj ... prezent.....etj..... Morena Boja.....mungon.

Kryetar ke 34 në sallë. *(Hyn në sallë pas apelit A.Ramohitaj dhe S.Aleksi dhe pas rendit të ditës hyn këshilltarja F.Qoshi.)*. Gjithsej 37 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi : Atëherë meqë kuorumi është i pranishëm vazhdojmë me mbledhjen.

Kemi sot për shqyrtim e miratim 10 pika, ku 4 pikat e fundit janë kërkuar të futen shtesë ne rendin e ditës.

Po prezantoj pikat një e nga një si më poshtë:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN DHJETOR 2021
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2022, SI DHE PROJEKTBUXHETIN AFATMESËM TË BASHKISË DURRËS PËR VITET 2022-2024
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	MBI MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM (PBA) PËR VITET 2023-2025 DHE BUXHETIT VJETOR
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2022
5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2021-2024, TË BASHKISË DURRËS
6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PROFESIONAL DHE KONVIKTEVE TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “BEQIR ÇELA” DHE SHKOLLËS SË MESME TEKNOLOGJIKE “HYSEN ÇELA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022

PIKAT SHITESË

Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR SI DHE KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË MESME SPORTIVE “BENARDINA QERRAXHIA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i	PËR NDRYSHIMIN DHE DETAJIMIN E PIKËS DY TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.575 DATË 20.12.2018 “PËR NDRYSHIMIN DHE DISA SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.60

projekt-vendimit	DATË 22.12.2005 “PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË VENDODHJEVE TË REJA TË VENDQËNDRIMEVE TAKSI (4+1) DHE (8+1) NË QYTETIN E DURRËSIT” DHE MIRATIMIN E KRITEREVE SHITESË PËR OPERATORËT TAKSI, QË KRYEJNË SHËRBIMIN TAKSI NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.55, DATË 26.06.2020, NR.64, DATË 07.07.2020, NR.81, DATË 10.08.2020, NR.11, DATË 04.02.2021 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR NË ZBATIM TË EKSPERTIZAVE TË THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT
Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TETË TË 25 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL

Ani Dyrmishi : Këto ishin dhe 10 pikat e rendit të ditës. Kush ka ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?

Atëherë nuk kemi komente, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet rendi ditës.

E ka kërkuar fjalën Kryetarja.

Kryetare!

Emiriana Sako : Faleminderit Kryetar!

Meqënëse sot kemi një pikë shumë të rëndësishme. Në fund të vitit “Ne” miratojmë buxhetin dhe paketën fiskale me ndryshimet që kemi propozuar në të, doja të bëja një prezantim të shkurtër të linjave të përgjithshme, që kemi marrë në konsiderat në hartimin e këtij buxheti, pavarësisht se një pjesë e këshilltarëve kanë qënë prezent në të gjitha dëgjesat që “Ne” kemi realizuar. Gjatë fazës së muajve tetor deri në dhjetor “Ne” kemi përgatitur 5 dëgjesa publike në mënyrë përkatëse në Njësinë Administrative Manëz dhe Ishëm është bërë një dëgjesë, në Rrashbull, Sukth , Katund i Ri është bërë dëgjesë për këto 3 njësi, në njësinë administrative 4 dhe 6 është bërë dëgjesa tjetër, kemi bërë një takim me bizneset pranë zyrave të bashkisë së Durrësit si dhe me njësitë administrative 1, 2, 3, dhe 5 kemi realizuar dëgjesën tek salla Blackbox e shkollës muzikës.

Në bazë të këtyre kërkesave, që janë reflektuar nga ana e qytetarëve , por edhe prioriteteve që kemi “Ne” si Bashki Durrës kemi marrë masa që në këtë buxhet të ri që propozojmë përsa i takon

infrastrukturës, investimeve në infrastrukturën rrugore kemi marrë në konsiderat akte të ndryshme rruge si dhe rikualifikimin e pallateve me veshjen e kapotës duke futur dhe konceptin e eficensës së energjisë, në mënyrë që të kemi ulje të konsumit të saj.

Prioritet në bashkinë e Durrësit janë përmbytyet dhe trajtimi i tyre me zgjidhje konkrete teknike . Përveç fondeve që “Ne” kemi marrë nga Ministria e Shtetit për Rindërtimin për rehabilitimin e hidrovorit të ri , kemi marrë në konsideratë që me realizimin e buxhetit të fusim fond për pastrimin e kanaleve të ujrave të bardha në zonën e plazhit si dhe ndërtimin e rrjetit K.U.B-ë e K.U.Z-ë si dhe sistemimin e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të bardha në rrugën Taulantia, pra në zonën A, pranë pishinës ku në qytetin tonë ka më shumë përmbytje.

Një rëndësi të veçantë i kemi dhënë ndriçimit të akseve kryesore, të rrugëve kryesore në qytet, po ashtu në zonën e plazhit dhe në zonën e Shkozetit, ku në këtë buxhet kemi parashikuar investime në 16 rrugë , 16 akse kryesore të cilat këto janë të detajuara në paketën e investimeve me një fond total prej 101 milion lekësh të reja ku do të parashikojmë ndrimin e komplet infrastrukturës rrugore nga ajo ekzistuese në rivendosjen me sistem ndriçimi Led.

Një element tjetër i rëndësishëm në gjykimin e Bashkisë ka qënë dhe siguria në qytet ku kemi marrë masa që të vendosim në akset kryesore për të ndihmuar edhe ndërmarrjet tona të vartësisë, policinë e shtetit, por edhe rritjen e popullsisë gjatë sezonit turistik, vendosjen e kamerave te sigurisë në qytet.

Përsa i takon më tej, pjesës tjetër të investimeve që është arsimiti, kemi realizuar me MSHR njëser objektivësh, të cilat kanë qënë të prekura nga tërmeti i 26 nëntor 2019, por me buxhetin e arsimit në zërin total të investimeve zë 14 % ky buxhet. Me fonde të ardhura nga bashkia Durrësit nga viti 2024 do të kemi të përfunduar 2 godina të reja shkollash 9 vjeçare, një godinë të re shkolle fillore, 2 shkolla 9 vjeçare të rikonstruara si dhe kemi vënë një theks të veçantë ngritjes së Këshillit Rinor, sa i takon për të ngjuar më shumë zërin e të rinjve në qytetin e Durrësit po nga ana tjetër kemi futur dhe investimin e plotë në Qendrën Kulturore të Fëmijëve, në mënyrë që të bëjmë rehabilitimin e plotë të saj e të kthimit sa më parë në funksionalitet.

Në ndihmë të fëmijve me aftësi ndryshe në vitin 2022 do të shtojmë 10 edukator nëpër këto njësi ku “Ne” ofrojmë shërbimin tonë si dhe numri i kopshteve me drekë rritet nga 9 kopshte në 2021, në 15 brënda 2024, pra shtohen përkatësisht 3 kopshte me ushqim ne 2022, 2 kopshte me ushqim në 2023 dhe 1 kopsht me ushqim në 2024.

Duke ju referuar dhe marrveshjes që kemi me Universitetin e Durrësit për t’ju ardhur në ndihmë 19 mijë studentëve, të cilët jetojnë dhe studiojnë në këtë qytet kemi marrë në konsiderat të fillojmë aplikimin e kartave të studentit dhe këtë parashikim për vitin 2022 do ta fillojmë më 2500 studentët e parë, të cilët i përkasin kategorive të familjes në nevojë dhe studentët ekselent, të cilët do të pajisen me këtë kartë ku “Ne” në bashkëpunim me bizneset do të ofrojmë lehtësira në fusha të caktuara si dhe në përdorimin e ambienteve publike, që kemi në qytet.

Investimet në arsim do të jenë : ndërtimi godinë e re shkollës 9 vjeçare Met Hasa, pra rikostruksioni i plotë i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, ndërtimi i një shkolle të re ku mendojmë të bashkojmë shkollat 9 vjeçare Vasil Ziu dhe Nën Tereza, rikostruksioni i shkollës 9 vjeçare Demokracia, rikostruksioni i shkollës Besnik Hidri, Shën Vlash si dhe rikostruksioni i shkollës Don Nikollë Kaçorri, ndërtimi i kopshtit të shkollës fillore në oborrin e shkollës Jusuf Hoti me bashkëfinancim me UNDP për programin e rindërtimit.

Një zë shumë i rëndësishëm të cilin e kemi shprehur në të gjitha dëgjuesat që kemi realizuar edhe me qytetarët ka qënë ai i menaxhimit të mbetjeve. Durrësi ka kaluar një situatë të vështirë gjatë vitit 2019 dhe 2020 dhe “Ne” kemi finalizuar marrëveshjen me pikën fundore të depozitimit në qytetin tonë dhe në bazë të kësaj me këtë buxhet kemi marrë masa që të forcojmë rolin e ndërmarrjeve dhe të rrisim shërbimet dhe investimet në këto 2 ndërmarrje, në mënyrë që të jemi të përgatitur edhe për shërbimin tonë gjatë gjithë vitit, por edhe për t’ju përgjigjur turizmit, i cili vjen gjithmonë në rritje në qytetin e Durrësit.

Buxheti për menaxhimin e mbetjeve rritet me 104 %, pra gati dyfishohet. Ky buxhet do të financohet, nga 441 milion ka shkuar në 1.38 miliard lekë dhe ky buxhet do të financohet nga 29.8 % nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve dhe 34% nga transferata e qeverisë për mbetjet dhe pjesa tjetër nga taksat dhe tarifatat vendore. Kemi parashikuar që me këtë fond që kemi rritur, të ndryshojmë flotën e ndërmarrjeve, në mënyrë që të kemi mundësi të aksesojmë dhe në zona ku ka trafik apo në zona ku turizmi ka një rritje të lartë gjatë sezonit turistik. Kemi parashikuar që të rrisim numrin e kontenerëve në qytet duke shtuar 1000 kosha të rinj në të cilët pjesërisht do të fillojmë dhe programin e diferencimit të mbetjeve që në burim, pra do të ngremë një zonë pilot. Gjithashtu kemi marrë masa me këtë fond të shtohen punëtorë sezonal, për të dhënë shërbime sa më të mira gjatë sezonit në pjesën e shkëmbit të Kavajës, zonën e plazhit që ka densitetin më të lartë dhe fluksin turistik. Gjithashtu rrisim të ardhurat nga tarifa e pastrimit me 25% më shumë se sa viti 2021.

Një zë tjetër i rëndësishëm që “Ne” e kemi buxhetuar për 3 vite është fondi për mbjelljen e pemëve në qytet, ku kemi vendosur një buxhet prej 50 milion për çdo vit, pra total 150 milion lekë, të cilat do të përkthen mbi një output mbi 10 mijë pemë të tjera shtesë në qytetin e Durrësit sa i takon këtij buxheti 3 vjeçar.

Nëqoftëse do të flasim për të ardhurat nga burimet e veta, parashikimi është tek 2 miliardë lekë ose 13% më shumë se 2021. Të ardhurat nga taksat janë 1.2 miliardë lekë ose 6.7% më shumë se viti 2021. Taksat vendore kemi parashikuar 865 milion lekë ose 7 % më shumë se viti 2021. Taksat e ndara në 370 milion ose 6 % më shumë se sa viti 2021. Të ardhurat nga tarifatat dhe pagesat e tjera janë 792 milion ose 24 % më shumë se sa viti 2021. Tarifa e pastrimit parashikohet 310 milion lekë me 25 % rritje nga 2021. Tarifa e ndriçimit 71 milion lekë më një parashikim rreth 9 % më shumë se viti 2021. Ajo e gjelbërimit 52 milion lekë me një rritje prej 8 %, tarifa e zënies së hapsirës publike 145 milion lekë me 60 % më shumë se sa viti 2021. Të ardhurat nga qeveria qendrore “Ne” kemi transfertën e pakushtëzuar dhe transfertën sektoriale me 1.65 miliardë lekë ose 23 % më shumë se sa viti 2021.

Gjithashtu e fundit është dhe kemi marrë masa që edhe me ngritjen e një sektori të posaçëm në bashkinë e Durrësit sa i takon turizmit për t’i dhënë prioritetin e nevojshëm, por edhe nga takimet që kemi pasur me grupet e interesit në këtë fushë kemi bërë parashikimet që të vendosim, të fillojmë të pajisim me sinjalistikë të dedikuar vetëm për turizmin zonat turistike, siç është ajo e plazhit dhe shkëmbit të Kavajës si dhe kemi vendosur një fond për pjesmarrjen dhe promovimin e qytetit në panairë të ndryshme ndërkombëtare në mënyrë që të kemi mundësi që Durrësi të jetë me vizibël dhe më i aksesueshëm dhe në arenën ndërkombëtare.

Ju falenderoj për vëmendjen dhe të gjitha këto që unë thashë janë të detajuara me shifra konkrete në buxhet në bazë të programeve specifike.

Ani Dyrmishi : Faleminderit Kryetare.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

- I japim fjalën **për projektvendimin e pikës 1**, Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, znj. Meçi.

Klementina Meçi: Faleminderit Kryetar! Përshëndetje të gjithëve! Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës, dhe konkretisht miraton kalimin e fondit për 90 familje nga të ardhurat e bashkisë dhe për 23 familje nga fondi i kushtëzuar 6%. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Përsa i përket pikës 1, kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 2 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Faleminderit z. Kryetar! Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të përgatitur nga Grupi për Menaxhimin Strategjik në Bashkinë Durrës vendosi me të gjitha votat pro miratimit të buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022 si dhe projektbuxhetit afatmesëm të Bashkisë Durrës 2022-2024.

Si kryetare e Komisionit nuk gjykoj se mund të shtoj diçka tjetër pasi të gjitha risitë për këtë projektbuxhet u prezantuan më së mirë gjatë fjalës hyrëse të Kryetares së Bashkisë znj. Emiriana Sako. Ju faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj.Bardhaj. Komente përsa i përket pikës 2 të rendit ditës kemi nga ana e këshilltarëve? Po z. Beqiraj.

Artion Beqiraj : Po, faleminderit. Përshëndetje të gjithëve.

Unë e dëgjova me vëmendje fjalën e Kryetares, jam munduar ta lexoj të gjithë materialin e buxhetit, e mbështes si këshilltarë. Doja të veçoja 2, 3 pika interesante, që mu dukën në lidhje me buxhetin. Siç ishte përshëmbull vendosja e një buxheti për hartimin projekteve integrale, që bën bashkia gjatë investimeve. Pra nëse flasim për investime rrugore, mos flasim vetëm për asfalt, por të flasim dhe për nënshtresat e tjera për infrastrukturën lidhëse, kanalizimet etj, etj..., pra që këto projekte të jenë integrale është shumë pozitive, sepse jo radhë herë mund të ketë ndodhur, s'po them që ka ndodhur që një investim duhet të rihapet sepse ka nevojë për punime të tjera shtesë.

Shumë interesante është, shumë i mirëpritur është edhe si rrjedhje e eksperiencës në 2 rrugë të tjera që kam parë përsa i përket ndriçimit në qytet, këtu flas për rrugën e markatës, rrugën e stadiumit dhe buxheti i bashkisë këtë herë shkon më së miri dhe në ndriçimin, duke veçuar, pra përveç ndriçimit por dhe cilësinë e ndriçimit, që bëhet fjalë për një ndriçim të një teknologjie më të lartë “Led” dhe që sjell dhe pastaj dhe eficientë në konsumin e energjisë.

E vlerësueshme është dhe rritja e buxhetit për pastrimin rreth 2 apo 2.5 herë më shumë. Kryetarja e shprehu shumë mirë shqetësimin që ka kaluar Durrësi. Ne e kemi parë. Kjo vëmendje tani është e mirëpritur, pasi gjithmonë e më shumë qyteti ka nevojë për këtë shërbim, i cili ndikon në jetën e banorëve, në zhvillimin e biznesit, por edhe turistëve që “Ne” i presim çdo vit.

Gjithashtu në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Turizmit doja të falenderoja dhe Bashkinë dhe Kryetaren për vëmendjen që pati në disa pika lidhur me çështjen e turizmit, siç është ajo e sinjalistikës në shkëmbin e Kavajës, pasi gjithmonë e më shumë Durrësi ka turist që vinë nga jashtë, përveçse nga jashtë që nuk janë dhe gjuhë folës shqiptarë dhe është shumë e mirëpritur sepse gjithmonë e më shumë turistët po përdorin shenjat konvencional, pra përmes gjuhës së përbashkët, të unifikuar, dhe jo më me vëndet, ta lëmë takimin këtu tek ky bar , etj.. etj... dhe kjo është shumë e mirëpritur, Ju falenderoj. Gjithashtu dhe investimi inxhinjerik që do të bëhet në rrugën Taulantia, por që mendoj që ka impakt dhe në çështjen e turizmit, bëhet fjalë për rrugën Taulantia pasi jo rradhë herë e konstatojmë që kur ka reshje shiu ajo menjëherë përmbytet, por ndërkohë bëhet fjalë për një nga nyjet turistike të qytetit jo vetëm nga jashtë, por edhe kur vinë nga qytetet e tjera shtunë të diel, “Ne” shikojmë që kjo zonë frekuentohet si një turizëm dhe i brëndshëm dhe i jashtëm, është shumë pozitive.

Faleminderit dhe për punën që keni bërë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z. Beqiraj. Komente të tjera nga ana e këshilltarëve ? Z.Kërtusha .

Klodian Kërtusha : Faleminderit Kryetar ! Faleminderit Kryetare !

Atëherë duke propozuar në lidhje me materialin dhe punën që keni kryer për projektbuxhetin e 2022-shit, unë u njoha dhe me pjesën e investimeve, tek pjesa e ndriçimit, tek pjesa e pastrimit. Unë do të pikasja diçka tek pjesa e ndriçimit. Janë rreth 11 investime që do të bëhen për pjesën e ndriçimit në zonën e qytetit, po ashtu dhe në zonat turistike. Po duke ditë që zona e gjirit të Lalëzit, aktualisht që po flasim janë rreth 4800 apartamente pa rezortin e ri që po bëhet, që vinë gjatë verës dhe ajo zonë duhet të mbulohet nga ndriçimi. Unë do të sugjeroja që vitin që vjen një pjesë e buxhetit, nëqoftëse ka mundësi të bëhet pjesa e ndriçimit rrugor, sepse është zonë kryesore pjesa e gjirit të Lalëzit dhe qendra, sepse qeveria shqiptare dhe bashkia Durrësit kanë investuar goxha në atë vënd si në lidhje me rrugët, me investimin 20 kilo volt-sh, me shpiat e tërmetit dhe ajo po bëhet një ndër zonat, domethënë po merr komplet zonë turistike. Një aspekt që është, një tipasr që është ndriçimi rrugor ajo kalon komplet në një zonë shumë të bukur dhe kemi mundësi dhe vjeljen e taksave pastaj dhe ke pjesa ndriçimit dhe ke të gjitha. Unë e kisha sugjerim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Po, Kryetare...

Emiriana Sako : Po, faleminderit.

Është shumë e vërtetë aksi që Ju përmendët në fakt ka qënë në mënaxhimin e ARRSH si aks rrugor ka kaluar vetëm këtë muaj në varësi të Bashkisë Durrës dhe “Ne” do të marrim masa që të hartojmë dhe projekte për këto akse, të cilat kanë kaluar së fundmi tek “Ne”.

Ajo që nuk e përmenda unë, sepse këtu sot flasim për buxhetin, është që Ne përveç investimeve që kemi futur në buxhetin e Bashkisë Durrës kemi patur bashkëpunim shumë të mirë me

institucionet e qeverisjes qëndrore, pra shumë nga projektet të cilët nuk i kemi përfshirë në këtë projekt i kemi në vijim me institucionet si FSHZH apo dhe institucione të tjera, të cilat merren me efikasitetin e energjisë duke hartuar projekte, të cilat janë të një standarti të caktuar, tentojmë europian patjetër, “Ne” kemi mundësi dhe të marrjes së financimit nga grantet që jep qeveria shqiptare. Kështu që këto akse, të cilat kanë një impakt të rëndësishëm dhe në buxhetin tonë “Ne” do tentojmë që mos t’ja japim barrën buxhetit të bashkisë, por të përpiqemi t’i marrim si financime nga qeveria shqiptare ashtu sic aktualisht kemi me Fondin Shqiptar të Zhvillimit 13 rrugë, të cilat ndodhen në zona të ndryshme në qytet apo siç kemi zonën e Ishmit, që sapo ka përfunduar investimi po me Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Kështu që Ju falenderoj për ndërhyrjen. Do ta kemi në konsiderat në hartimin e projekteve tona.

Ani Dyrmishi: Faleminderit Kryetare..

Atëherë komente të tjera përsa i përket pikës 2 nga këshilltarët , kemi tjetër ?

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës? Kundra ?.... Apstenim ?..... Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 3**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Faleminderit !

Edhe për këtë pikë Komisioni ynë, votoi me të gjitha votat pro miratimit të saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës kemi nga ana e këshilltarëve?

Ka komente Artion ? ...

Artion Beqiraj : Jo

Ani Dyrmishi: Atëherë ok, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ?.....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 4 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Për këtë pikë “Ne” vendosëm me të gjitha votat pro miratimit të saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit znj. Bardhaj.

Komente përsa i përket pikës 4 kemi nga ana e këshilltarëve?

Po z. Beqiraj.

Artion Beqiraj : Atëherë në lidhje me paketën dhe nga informacionet që kemi marrë përsa i përket dëgjesave publike ka patur një diskutim mbi tarifën e pastrimit për shkak të një rritje që parashikohet në paketën fiskale. Personalisht unë do ta konsideroja jo një rritje, por një korigjim në fakt, dhe një korigjim që vjen përshtat nevojës që ka bashkia, pra është një korigjim që bëhet, natyrshëm që vjen në rritje pasi nevojat e qytetit janë të shtuara për shërbimin e pastrimit, por edhe sepse tarifa e pastrimit në bashkinë e Durrësit relativisht ka qënë e ulët dhe me qytete si motra të kategorisë parë në vend. Sugjeroj që të shikohet në këtë aspekt, pra jo thjesht si një rritje por si një korigjim rritës, që do t'i shërbej qytetit. Sfidat që i shtohen bashkisë është menaxhimi tashmë i pastrimit ose duke u rritur dhe tarifa shtohen dhe përgjegjësit e mirëmemaxhimit të shërbimit.

Gjithashtu vura re se këtë vit propozohet dhe një taksë e përkohshme, që është taksa për arsimin, e cila i ngarohet bizneseve të mëdha. Dhe këtë aspekt e shikoj pozitiv pasi bashkia ka investuar bashkë me qeverinë në fushën e arsimit dhe do të ketë më shumë nevojë për mirëmbajtjen, që është dhe tagër ekskluziv i bashkisë. Një detaj do të doja të pyesja këtu përsa i përket përcaktimit të biznesit të madh. Nuk e di nëse nga bashkia. Pra flitet për një taksë që i caktohet biznesit të madh, por kjo do të lidhet me xhiron që realizon apo ka ndonjë vlerësim tjetër nga do të merret. E thënë kjo, pasi sipas kolegëve ekspertë që flasim herë pas here ka mendime të ndryshme sa i përket kategorizimit të biznesit të madh. Disa kolegë mbajnë qëndrim që biznesi i madh do të konsiderohet ai, që bën xhiron mbi 8 milion lekë, ndërsa disa të tjerë mbajnë qëndrim që biznesi i madh do të konsiderohet ai, që bën xhiron mbi 14 milion lekë. Nuk e di nëse Bashkia e ka vlerësuar këtë aspekt, nëse ka arritur ta detajojë. S'jam kundër vendosjes, por më tepër për aplikimin e saj që të jetë e qartë dhe ky mesazh do t'i ndihmojë dhe bizneset.

Këto kisha sa i përket paketës, pjesët e tjera janë ok.

Emiriana Sako : Nuk e di nëse ka staf këtu që të jap një përgjigje për pyetjen për taksën e përkohshme që kemi vendosur për arsimin. Nikoleta je këtu ? Po.

Ani Dyrmishi: Të lutem Nikoleta mikrofonin.

Nikoleta Rusha : Përsa i takon pyetjes, që bëri Artioni neve numrin e bizneseve të mëdha e kemi marrë nga Drejtoria e Tatimit Taksave dhe ai është një numër fikse, që na është dhënë. Nga ana e Drejtorisë tonë me ekspertë nga Tirana dhe konkretisht nga Fakulteti i Ekonomisë kemi bërë një analizë të faktit që përveç atyre që ka investuar bashkia neve na duhet të bëjmë investime në tre drejtime.

Drejtimi i parë në infrastrukturë dhe kur flasim për infrastrukturë flasim për fshatra të thella të zonës së Ishmit, të zonës së Manzës siç janë Draç i poshtëm, siç janë në Gjuricaj ose Shkalla në Manëz apo Kamerasi në Rad , pra fshatra të vegjël të cilët nuk kanë perspektivë rritje, por ama kanë fëmijë deri në 25 fëmijë dhe kanë kushte tepër të mjerueshme në kopshtet e tyre dhe mendojmë që me këtë taksë neve të investojmë pikërisht në këto kopshte, pra që i takojnë një komuniteti të vogël, por ama që kanë dhe ato rëndësinë e tyre .

Kurse e dyta në lidhje me taksën është e lidhur me shkollat e reja si të rindërtuara nga Ministria e Rindërtimit me fondet e Qeverisë Shqiptare apo fondet e BE-së ashtu dhe me fondet e Bashkisë Durrës. Dhe për këto “Ne” kemi menduar që meqënëse në njësitë administrative apo dhe në Durrës

aty ku ka mundësi kemi oborre, të bëjmë, të krijojmë hapsira rekreative dhe të vëmë kënde lojrash për fëmijët të cilët nuk kanë qënë të parashikuara në projekte. Atë projekt që është i standarteve europiane ta plotësojmë dhe me kënaqësinë e fëmijëve për të realizuar dhe lojën në këto kopshte. Dhe e treta që “Ne” kemi menduar është e lidhur kryesisht me mjete didaktike në pamundësi nëqoftëse nuk do t’i marrim nga ministria, sepse nga një rishikim që i bëra buxhetit të Ministria e Arsimit ato kanë parashikuar në 22-24 një fond për to, sepse janë investime që “Ne” i bëjmë 1 herë në 10 vjet, pra mbushen kopshtet me këto gjëra.

Ndërsa përsa i takon biznesit neve i kemi marrë nga Drejtoria e Taksave dhe ato janë 4035 biznese, që mendoj që janë më xhiron mbi 14 milion, për pjesën tjetër nuk është menduar të taksohet dhe vlera e kësaj takse është vetëm 1 mijë lekë në muaj, pra 12 mijë lekë në vit dhe vetëm për biznesin e madh dhe jo për kategorinë familjare dhe të voglin.

Ani Dyrmishi: Atëherë Artion i qartë ?

Artion Beqiraj : Po.

Ani Dyrmishi: Atëherë komente të tjera përsa i përket pikës 4 ka ?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ?.....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **projektvendimit e pikës 5**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, znj. Meçi.

Klementina Meçi: Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim edhe pikën 5 « Planin Social të Bashkisë Durrës për 2021-2024 » dhe vendosi që ta miratoj dhe ta kaloj për miratim në këshill bashkiak Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Meçi.

Komente përsa i përket pikës 5, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **e pikës 6 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj. Jolanda Mustafaraj.

Jolanda Mustafaraj : Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit për pikën 6 për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit profesional ra dakort që kjo pikë të kaloj.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Mustafaraj.

Komente përsa i përket pikës 6, nga ana e këshilltarëve kemi ? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **e pikës 7 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj. Jolanda Mustafaraj.

Jolanda Mustafaraj : Edhe për këtë pikë Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, ra dakort që dhe kjo pikë të kaloj. Është pro miratimit të listës së nxënësve të arsimit parauniversitar.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 7, ka nga ana e këshilltarëve ? Atëherë nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ?Nuk ka.

Atëherë miratohet me 37 vota pro dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **e pikës 8 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Alfred Mullaraj.

Alfred Mullaraj : Komisioni ra dakort për pikën 8, nuk kishte asnjë kundërshtim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Mullaraj.

Përsa i përket pikës 8, kemi komente nga ana e këshilltarëve ? Po z. Kërtusha.

Klodian Kërtusha : Në lidhje me pikën 8, kisha vetëm një sugjerim, siç dihet tani pjesa e makinave ecodrive, pjesët e karikimit. Pika karikimi për makinat elektrike po bëhet risi, po bëhet jetike. Unë isha i mendimit të shtohen dhe pikat e karikimit të makinave, sepse këtu po shtohen. Në Tiranë janë me shumicë. Unë këtë sugjerim kisha.

Ani Dyrmishi : Atëherë faleminderit.

Komente përsa i përket kësaj pike të tjera kemi ? Po, Eva.

Etleva Budini : Për Klodianin e kisha këtë. Pranë postës filiali Durrës janë tre pika karikimi dhe unë kam qënë në kontakt të vazhdueshëm me disa nga kompanitë e taksive, të cilët po lidhin kontrata, shrehimisht po them me kompani taksish, me kompani jo me individë deri tani . Kështu që në Durrës ekziston një mundësi për karikimin e makinave elektrike, që është pranë zyrave të postës dega Durrës. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit Znj. Budini.

Komente të tjera?

Komente të tjera, përsa i përket pikës 8, kishim ?

Nuk ka. Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në **shqyrtimin e pikës 9 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi: Përshëndetje!

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike përsa i përket miratimit të ndryshimit të VKB nr.55, për ndryshimin e listës emërore të familjeve përfituese të grantit për rikonstruksionin e banesave, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 9. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar !

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 9, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 10**, i japim fjalën për projektvendimin e pikës 10 Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim edhe pikën 10 të rendit të ditës, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Po, Kryetar !

Edhe për pikën 10 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 10, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 10 e rendit ditës.

Kryetare, nëse dëshiron fjalën.

Emiriana Sako : Faleminderit.

Në mbyllje desha t'Ju falenderoj të gjithëve për punën që është bërë gjatë këtij viti .

Ju uroj festa të gëzuara dhe një vit të mbarë, Ju dhe gjithë qytetarëve të Durrësit. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit Kryetare.

Atëherë duke Ju uruar dhe unë festat e fundvitit t'i kaloni sa më gëzuar me familjet tuaja, këtë mbledhje të fundit të vitit kalendarik e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit të gjithëve.

Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 13(trembëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetari Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetari Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetare Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI